



Financuar nga
Bashkimi Evropian



National Center for Community Services
Qendra Kombëtare për Shërbime Komunitare



THIRRJE E HAPUR PËR T'U BASHKUAR NË RRJETIN AVOKUES PËR KULTURËN – CULTUR-AL

- *A jeni një artist, një manaxher i një organizate kulturore apo një sipërmarrës që vepron në sektorin e kulturës?*
- *Jeni gazetar i fushës së kulturës, një studiues i trashëgimisë, apo një aktivist që dëshiron të ndikojë në politikat kulturore të Shqipërisë?*
- *Jeni një i ri që beson se kultura është e ardhmja dhe kërkon hapësira për të kontribuar në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore?*
- *Atëherë ky rrjet është mundësia dhe hapësira juaj për të bërë pjesën tuaj në mbrojtjen e kulturës dhe për të garantuar që zëri juaj të ndikojë në politikat kulturore të vendit!*

Pse duhet një rrjet kombëtar për kulturën?

Në një kohë kur arti dhe trashëgimia kulturore po përballen me sfida të mëdha, kur projektet kulturore mbeten në margjinat e politikave publike dhe kur mungesa e bashkëpunimit mes aktorëve të kulturës po dobëson ndikimin e tyre, është jetike të krijojmë një zë të përbashkët për kulturën në Shqipëri.

Ashtu si në shumicën e vendeve evropiane, edhe në Shqipëri, rritja e shpejtë e turizmit po krijon një presion të madh mbi trashëgiminë kulturore. Me miliona turistë që vizitojnë çdo vit vendet e trashëgimisë dhe qendrat kulturore, sfidat për ruajtjen e tyre po bëhen gjithnjë e më të mëdha. Institucionet përballen me një rritje eksponenciale të fluksit turistik, pa pasur mundësinë të përshtatin kapacitetet e tyre, ndërkohë që mungojnë fondet dhe mekanizmat për të investuar në mirëmbajtjen dhe mbrojtjen afatgjatë të trashëgimisë kulturore.

Ndërkohë, në shumicën e qyteteve dhe zonave rurale shqiptare, aty ku ndodhet trashëgimia jonë kulturore, hapësirat për art dhe kulturë janë të kufizuara ose inekzistente. Qendrat historike shpesh shihen thjesht si atraksione turistike, ndërsa mundësitë për zhvillimin e artit dhe jetës kulturore në komunitete mbeten të pakta. Mungesa e investimeve në infrastrukturë kulturore dhe mosprioritizimi i nismave artistike afatgjata dhe të kordinuara, po krijojnë një boshllëk në ekosistemin kulturor, duke e bërë edhe më të vështirë mbrojtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë sonë.

Në Shqipëri, kapacitetet për të menaxhuar këtë situatë mbeten të kufizuara. Politikat publike ende nuk e kanë integruar plotësisht rolin e kulturës si një shtyllë e zhvillimit të qëndrueshëm. Trashëgimia kulturore rrezikon të mos mbrohet si duhet, ndërsa arti dhe krijimtaria po përballen me mungesë mbështetjeje dhe hapësirash për zhvillim.

Kultura nuk mund të mbetet e anashkaluar, e harruar apo e keqpërdorur. Prandaj, po krijojmë një rrjet kombëtar të organizatave, gazetarëve, sipërmarrësve dhe aktivistëve që të bashkojnë forcat për të siguruar që kultura të mos mbetet në harresë!



Financuar nga
Bashkimi Evropian



National Center for Community Services
Qendra Kombëtare për Shërbime Komunitare



Çfarë është Rrjeti CULTUR-AL?

Rrjeti është një platformë për:

- Forcimin e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile (OSHC) dhe aktorëve të kulturës në avokim dhe monitorim të politikave publike.
- Krijimin e një zëri të përbashkët për të ndikuar në reformat kulturore dhe mbrojtjen e trashëgimisë.
- Ndërtimin e aleancave dhe partneriteteve midis OSHC-ve, artistëve, gazetarëve, sipërmarrësve të kulturës dhe institucioneve publike.
- Promovimin dhe përdorimin e teknologjisë dhe inovacionit për të ruajtur dhe zhvilluar kulturën dhe trashëgiminë.

Pse t'i bashkoheni këtij rrjeti?

- Trajtime dhe ekspertizë në avokim, politikë kulturore dhe përdorim të teknologjisë për mbrojtjen e trashëgimisë.
- Angazhim në nisma avokuese dhe dialogje me institucionet për të përmirësuar politikat në sektorin e kulturës.
- Rrjetëzim me organizata dhe profesionistë të kulturës nga Shqipëria dhe rajoni.
- Pjesëmarrje në projekte dhe iniciativa për zhvillimin e qëndrueshëm të kulturës dhe përfaqësimin e interesave të komunitetit kulturor.
- Mundësi për të ndikuar në monitorimin dhe mbikëqyrjen e politikave kulturore.

Kush mund të aplikojë?



Organizata të shoqërisë civile që punojnë në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë.



Aktivistë, avokues dhe studiues të angazhuar në çështjet e kulturës.



Institucione dhe aktorë që punojnë për politikat dhe reformat kulturore.



Sipërmarrës të kulturës dhe profesionistë të sektorit krijues.



Të rinj dhe studentë të interesuar për të ndikuar në politikën kulturore dhe mbrojtjen e trashëgimisë.



Financuar nga
Bashkimi Evropian



National Center for Community Services
Qendra Kombëtare për Shërbime Komunitare



Si të aplikoni?

Dërgoni një email me këto informacione:

- Një përshkrim të shkurtër të organizatës/individit dhe angazhimit në fushën e kulturës.
- Një letër interesi që shpjegon pse dëshironi t'i bashkoheni rjetit.
- Kontaktet e individit/përfaqësuesit të organizatës.

Afati i fundit për aplikime: **28 Shkurt 2025.**

Dërgoni aplikimin në:

✉ arlinda.cultural@gmail.com, nccs.albania@gmail.com, ngo.artivista@gmail.com

Për pyetje dhe informacion shtesë, na kontaktoni deri më 26 Shkurt 2025.

Bashkohuni me Rjetin CULTUR-AL dhe bëhuni pjesë e ndryshimit!

CulturAL

**Ruajmë, mbrojmë dhe fuqizojmë
kulturën dhe trashëgiminë kulturore
në Shqipëri - SË BASHKU!**

